



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dohetuar Prindur / Pristato Received / Delivered	04.03	2021	1	viti год year
Organ / Rjesht Organ / Решит Org / Rshut	SKPMARK	975/2021	Shirpa e Prilog Прилози	Sasia Kolicina Quantity
				113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.72/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-Kryetare e Kolegjit, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Hysni Mustafa-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.72/2021 të datës 12.02.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë fshati Shipashnic e Epërme, Komuna e Kamenicës, kundër organit të punësimit Komuna e Kamenicës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 04.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.72/2021 të datës 12.02.2021, e parashtruar nga ankuesi

II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

A r s y e t i m

Komuna e Kamenicës me datë 25.08.2020 ka shpallur konkursin publik për pozitën „Mbështetës Profesional për Trashëgimi Kulturore“, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi

Ankuesi, i pakënaqur me njoftimin për kandidatin e suksesshëm për pozitën „Mbështetës Profesional për Trashëgimi Kulturore“, ka parashtruar ankesë në Komunën e Kamenicës, mirëpo Komuna e Kamenicës nuk e shqyrton ankesën tij



Ankuesi i pakënaqur me mos shqyrtimin e ankesës së tij, nga ana e Komunës së Kamenicës, përmes emailit zyrtar ankesa.kpmshck@rks-gov.net me datën 12.02.2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila ankesë është pranuar në Këshill me datën 12.02.2021 dhe është protokolluar me numër të protokollit 606/2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 16.02.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Kamenicës. Me datën 02.03.2021, Këshilli përmes e-mailit zyrtar ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Kamenicës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 12.02.2021 me Nr.Prot:606/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 16.02.2021; Përgjigja në kërkesë e datës 02.03.2021; Emali zyrtar i datës 02.03.2021; Konkursi Nr.02/18388 i datës 25.08.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i'u referuar provave të lëndës, konstaton se Komuna e Kamenicës hapjen e konkursit të datës 25.08.2020 e ka bërë duke u mbështetur në: Ligjin e Punës Nr.03/L-212, Ligjin Nr.03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.10/2018 për Normativen e Kuadrit Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.1/2005 për Mësim me Zgjedhje të MASHT-it.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara nga organi i punësimit - Komuna e Kamenicës, ka konstatuar se, sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat Publike përkatësisht nenit 2 paragrafit 4 përcaktohet se: *4. Nëpunësi i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se zyrtarët publik të nivelit të lartë drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të Institucioneve Publike të Arsimit, respektivisht në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Komunën e Kamenicës, kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publik. Duke marrë parasysh se pozita për të cilin ka aplikuar ankuesi, me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrat Publike i përkasin kategorisë së nëpunësve të *Shërbimit Publik*, Kolegji vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për nëpunësit me status të shërbimit publik.*

Bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të vendosur vetëm për nëpunësit civil dhe kandidatët për pranim në Shërbimin civil, siç është përcaktuar në nenin 2 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe paragrafi 3 si dhe nenin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat Publike.



Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e ankuesve, udhëzon palët për ushtrimin e mjeteve juridike bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 74 si dhe nenin 24 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *“Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente”*.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.72/2021

Hysni Mustafa

Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Kamenicës ;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Kamenicës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

